



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

2425
02.06.2015

Nr.Regj. Themeltar 5731/1298

Date 02.07.2014

Nr. 1098 Vendimi

Date 20.05.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata Administrative e Apelit e perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES : ARTUR MALAJ

ANETARE : LINDITA SINANAJ

ANETARE : ALTINA NASUFI

asistuar nga sekretare gjyqesore Ermelinda Nuraj, ne dhome keshillimi te dates 20.05.2015, mori ne shqyrtim çeshjen qe u perket paleve :

PADITES : Syrja **Dudushi**, i biri i Hilmiut dhe Donikes, dtl.28.02.1974, lindur dhe banues ne lagjen “Muzakaj” Berat

TE PADITUR :

- 1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Berat**
- 2. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, (Drejtoria e Apelimit Tatimor), Tirane**

OBJEKTI : Anullim i Njoftim - Vleresimit te Detyrimit Tatimor Nr.1358, dt.25.04.2012 dhe Anullim i Vendimit te dt.09.07.2012 te Drejtorise se Apelimit Tatimor, Tirane.

BAZA LIGJORE : Ligji nr. 9920, dt. 19.05.2008, nenet 106, 107, 108, 109, 122/1, g “a”, Per Procedural Tatimore ne Republiken e Shqipersise;

“Udhezimi i VKM Nr.781, dt. 14.11.2007 dhe ligji Nr. 10488, dt.05.12.2008.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat me vendimin Nr. 1675, dt. 05.12.2012, ka vendosur:

- Rrezimin e kerkese padise te bera nga pala paditese, Syrja Dudushi, si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales paditese.

Kunder vendimit Nr. 1675, dt. 05.12.2012, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat, ka paraqitur ankim pala paditese, qe kerkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padise, duke parashtuar keto shkaqe:

- Gjykata ka marre te mireqene Akt-Konstatimin dhe Procesverbal-gjobe dt. 11.04.2012 duke u shprehur se pezullimi i lejes nuk me ka penguar mua si paditesin te ushtroj aktivitetin tim. Sipas gjykates i bie qe une kam konsumuar dy shkelje ligjore duke udhetuar pa leje drejtimi.
- Ne akt konstatim dhe procesverbal gjobe inspektoret nuk kane percaktuar se me cfare dokumenti eshte identifikuar drejtuesi i mjetit dhe ne seance gjyqesore u shprehen se nuk e mbanin mend drejtuesin e mjetit.
- Duke ju referuar ketyre konstatimeve dhe pretendimit te gjykates se une kam udhetuar pa leje drejtimi, lind pyetja se si eshte identifikuar drejtuesi i mjetit nga inspektoret. Ne nje suate te tille del se akti i konstatimit dhe procesverbali jane mbajtur ne menyre te njeaneshme nga i padituri duke u mbeshtetur thjesht me te dhenat qe ekzistojne ne sistem. Shenimi i faktit qe shkelesi “refuzon marrjen” e mbeshtet kete arsyetim.

Gjykata e Apelit Vlore me vendimin Nr. 118/60 – 2014 – 1020, dt. 24.04.2014, ka vendosur:

- Moskompetencen e Gjykates se Apelit Vlore per gjykimin e ceshtjes civile me nr. 287 rregjistri, me date rregjistrimi 31.01.2013.

- Dergimin e akteve te kesaj ceshtje civile per kompetence Gjykates Administrative te Apelit.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit Artur Malaj ne dhome keshillimi:

VEREN

Rrethanat e faktit :

Paditesi Syria Dudushi eshte banues ne lagjen “ Muzakaj ” te Qytetit te Beratit. Paditesi ka rezultuar se eshte i pajisur me licence per ushtrimin e aktivitetit privat me objekt: “Transport udhetaresh 8 + 1”, me NIPT Nr. K 82525002R dhe vete punon si shofer dhe ka ne pronesi automjetin me targe: AA 474 BK, Marka gjermane, Tip Benz, Lloji Veture.

Paditesi Syrja Dudushi eshte njoftuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Berat per “Njoftimin e Vleresimit te Detyrimit Tatimor (gjobe) te dt.25.04.2012 ne Shumen prej 100.000 (nje qind mije) leke”. Po keshtu, ka rezultuar se ky akt “Njoftim Vleresimi” eshte marre mbi bazen e Akt - Konstatimit te Inspektoreve te Drejtorise Rajonale Tatimore, Durres, me dt. 11.04.2012 dhe ne proces-verbalin e konstatimit te po kesaj date.

Ndaj ketij akti adminsitrativ, Njoftim - Vleresimit te Detyrimit Tatimor me nr.Prot, dt.25.04.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat, paditesi Syrja Dudushi ka ushtruar ankimin administrative prane pales se paditur, Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane. Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane, me vendimin e dt.09.07:2012, nr.9212/1 Prot., pasi ka shlyrtuar kerkesen e pales paditese ka vendosur te lere ne fuqi Njoftim - Vleresimin e Detyrimit Tatimor me nr.Prot., te dt.25.04.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat,.

Ndaj ketyre dy akteve administrative te sipercituara, pala paditese duke mos qene dakort ka paraqitur padi ne gjykate.

Vleresimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat :

Gjykata ka cmuar se kerkese padia eshte e pabazuar ne prova dhe ne ligj dhe ka vendosur rrezimin e saj.

Gjykata ka cmuar se paditesi Syrja Dudushi nuk ka arritur te provoje ne gjykim se Njofitim - Vleresimi i Detyrimit Tatimor (gjobe), dt.25.04.2012 ne Shumen 100.000 (nje qind mije) leke eshte i pabazuar. Ne gjykim eshte provuar se *de facto* paditesit Syrja Dudushi per periudhen kohore nje mujore, duke filluar nga dt.05.04.2012 deri me dt.04.05.2012, i eshte pezulluar leja e drejtimit te automjetit, me vendimin nr.3204, te dt.09.04.2012 (sipas Vendimit te Komisionit te Njesise Rajonale te Policise Rrugore, Fier), por ne kundersiztim me ligjin ka ushtruar veprimtarine e tij, me objekt aktivitetit "Transport Udhetarësh". Ky fakt eshte provuar me Proces-verbal Gjobe te dt. 11.04.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Durres, si dhe me Akt-Konstatimi, dt.11.04.2012 i Drejtorise Rajonale Tatimore Durres..

Ne deshmitet e dhena perpara gjykates ne seance gjyqesore te dt.03.12.2012 te dy deshmitaret, inspektoret Artur Canaku dhe Gasprin Lilaj, te cilet jane dhe perpiluesit e Akt-Konstatimit dhe te Proces-Verbal Gjobes te dt. 11.04.2012, eshte vertetuar fakti se me dt. 11.04.2012 kane ushtruar kontroll per paisjen fiskale taksimeter dhe nga kontrolli i ushtruar ka rezultuar se paditesi Syrja Dudushi levizte pa taksimeter. Ne keto rrethana, gjykata ka konstatuar se subjekti Syrja Dudushi ka vepruar ne kundersiztim me kriteret e nenit 21 pika 1 germa g (a) te ligjit 9920, dt. 19.05.2008, si dhe nenit 106, 107 te po ketij ligji "Per procedurat tatimore ne republiken e Shqiperise".

Persa i perket shpenzimeve gjyqesore si pjese hetimit gjyqesore, gjykata ka vendosur qe te ngarkoje me pagimin e tyre palen paditese, meqenese padine e ka cmuar te pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Vleresimi i Gjykates Administrative te Apelit :

Gjykata Administrative e Apelit, nisur nga provat dhe faktet e administruara ne dosjen gjyqesore, cmon se vendimi i mesiperme i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat eshte i bazuar ne prova e ligj dhe si rrjedhoje duhet te lihet ne fuqi.

Paditesi padine e tij ne kundersiztim te dy akteve administrative te sipercituara e bazon ne faktin se, me dt. 11.04.2012 sipas akt - konstatimit te Inspektoreve te Drejtorise Rajonale te Tatimeve, Durres nuk ka qene ne ushtrimin e aktivitetit te tij, per te cilen dhe eshte licensuar, pasi nuk ka qene i pajisur me leje drejtimi automjeti, e cila i eshte pezulluar per nje periudhe nje mujore, qe fillon nga dt.05.04.2012 deri me dt.04.05.2012, nxjerre nga Drejtoria Rajonale Policise Rrugore, Fier.

Ky fakt eshte vertetuar me Vendimin nr.3204, dt. 09.04.2012, i leshuar nga Drejtoria e Policise Rrugore, Komisariati i Policise Rrugore Fier, si dhe me Vertetimin nr.65 Prot., dt. 16.11.2002. Gjykata cmon se objekt gjykimi nuk eshte leja e drejtimit te automjetit por dy akte administrative, Njofitim - Vleresimi te Detyrimit Tatimor Nr.1358, dt.25.04.2012 dhe Vendimi i dt.09.07.2012 i Drejtorise se Apelimit Tatimor, Tirane. Fakti qe ne drejtimin e mjetit ka qene apo jo paditesi nuk eshte objekt I ketij gjykimi , objekt i ketij gjykimi eshte fakti nese paditesi ka perdorur apo jo pajisjen fiskale, taksimeter.

Gjykata cmon se paditesi Syrja Dudushi nuk ka arritur te provoje ne gjykim se Njofitim - Vleresimi i Detyrimit Tatimor (gjobe), dt.25.04.2012 ne Shumen 100.000 (nje qind mije) leke eshte i pabazuar. Ne gjykim eshte provuar se paditesit Syrja Dudushi per periudhen kohore nje mujore, duke filluar nga dt.05.04.2012 deri me dt.04.05.2012, i eshte pezulluar leja e drejtimit te automjetit, me vendimin nr.3204, te dt.09.04.2012 (sipas Vendimit te Komisionit te Njesise Rajonale te Policise Rrugore, Fier), por pavaresisht kesaj rezulton se paditesi ka ushtruar veprimtarine e tij, me objekt "Transport Udhetarësh". Ky fakt eshte provuar me Proces-verbal Gjobe te dt. 11.04.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Durres, si dhe me Akt-Konstatimi, dt.11.04.2012 i Drejtorise Rajonale Tatimore Durres.

Rezulton se nga, kontrolli i ushtruar nga inspektoret Artur Canaku dhe Grespin Lilaj ka qene i bazuar ne urdherin e punes Nr. 850 prot.

Referuar aktit te konstatimit nr. 0236654, dt. 11.04.2012, rezulton se subjekti Syrja Dudushi nuk ka qene i pajisur me paisje fiskale taksimeter. Pra,rezulton se subjekti Syrja Dudushi ka vepruar ne kundersizim me kriteret e nenit 21 pika 1 germa g (a) te ligjit 9920, dt. 19.05.2008, si dhe nenit 106, 107 te po ketij ligji "Per procedurat tatimore ne republiken e Shqiperise".

Paditesi Syrja Dudushi vertet ka qene i pezulluar me leje automjeti per periudhen 05.04.2012 deri 04.05.2012, por nga teresia e provave te shqyrtuara ka rezultuar se paditesi Syrja Dudushi nuk e ka ndaluar ushtrimin e veprimtarise se tij private me objekt transportim udhetarësh.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar ne nenin 50/1/b te Ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

VENDOSI

- Lenien ne fuqi te Vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat me Nr. 1675, dt. 05.12.2012.
- U shpall, sot me date 20.05.2015, ne Tirane.

ANETARE

LINDITA SINANAJ

dv

ANETARE

ALTINA NASUFI

dv

KRYESUES

ARTUR MALAJ

dv

Vertetohet njesia me origjinalin

*Kancelari
Leonard Stacaj
Stacaj*